



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 56, Datë 09.03.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E DRAFT – “KONTRATËS TIP PËR SHIT-BLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË ENERGJISË ELEKTRIKE QË REZULTON PAS PËRMBUSHJES SË KËRKESËS SË KLIENTËVE QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI UNIVERSAL, ME QËLLIM MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR PERIUdhËN KOHORE 01.01.2018-31.12.2018”.

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 5 të VKM nr. 244 dt.30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, që ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 23.06.2016, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 09.03.2018, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE për fillimin e procedurës për miratimin e kontratës Tip për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2018-31.12.2018,

Konstatohet se:

- Shoqëria “OSHEE sh.a.” me shkresën nr. 3998/1 Prot, datë 06.03.2018, ka përcjellë në ERE draftin e “Kontratës për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2018-31.12.2018”.
- Kontrata për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2018-31.12.2018 rezulton e panëshkruar nga të dy palët.

- Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.244, datë 30.03.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", ndryshuar me VKM. 729 datë 08.12.2017 përcaktohet se Kontrata ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe prodhuesit të energjisë elektrike miratohet nga ERE
- Në datë 07.03.2018, u depozitua në ERE shkresa e shoqërisë KESH sh.a. me nr 1017/3 datë 07.03.2018 dhe nr. 186/7 Prot. datë 07.03.2018 të ERE.
- KESH sh.a. bën me dije se pavarësisht diskutimeve për të arritur në një draft të dakortësuar të kësaj kontrate, ka patur dispozita të saj të cilat nuk kanë gjetur dakortësinë e Palëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e kontratës Tip për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2018-31.12.2018.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a, KESH sh.a, OST sh.a, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Konkurrencës, për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet Ankim në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare .

KRYETARI
Petrit AHMETI